



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

ARSIMI PROFESIONAL

KURRIKULA Bërthamë

**Programi mësimor për fushën: Makineri, Prodhim dhe
Ndërtimtari
Profili arsimor: “Konstruktionet Metalike”**

**Niveli 3 dhe 4 sipas Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës
Shkalla 5 dhe 6 e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës
Klasat 10, 11 dhe 12**

Kosovë, 2023

PËRMBAJTJA

I. Parathënie

II. Kurrikula për profilin “Konstruksionet Metalike”, klasat 10,11 dhe 12

- 1. Njoftime të përgjithshme për profilin “Konstruksionet Metalike”, klasat 10,11 dhe 12**
 - a. Struktura e shkollimit dhe certifikimi.
 - b. Kërkesat e pranimit të nxënësve.
 - c. Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe të punësimit.
 - d. Qëllimet e përgjithshme të shkollimit.
 - e. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve.
 - f. Kompetencat profesionale të nxënësve.
- 2. Plani mësimor i profilit “Konstruksionet Metalike”, klasat 10,11 dhe 12**
- 3. Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë.**
- 4. Përshkruesit e moduleve profesionale**
 - a. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 10-të
 - b. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 11-të
 - c. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 12-të

I. Parathënia

Në këtë mënyrë, MASHTI synon të zhvillojë një kulturë të përgjithshme unike për të gjithë nxënësit që përfundojnë shkollat profesionale.

Programet e reja të lëndëve të përgjithshme, së bashku me ato të lëndëve e të praktikave të ndryshme profesionale, do të sigurojnë një formim bashkëkohor, sa i përket kulturës së përgjithshme dhe profesioneve të ndryshme gjatë tri viteve të shkollimit profesional, duke synuar të përgatisin brezin e ri si qytetarë të ardhshëm të një shoqërie të lirë e demokratike, të aftë për t'u ballafaquar me sfidat e zhvillimit kulturor e ekonomik dhe me kërkesat e tregut të punës, kërkesave universitare në shkallë vendi, rajoni e më gjerë.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit i fton të gjithë mësime të mesimit dhe drejtuesit e shkollave profesionale, specialistët, prindërit, nxënësit dhe të gjithë të interesuarit për zhvillimin e sistemit të Arsimit të Mesëm të Lartë Profesional të Kosovës të japin ndihmesën e tyre për ngritjen e nivelit të këtyre shkollave në nivel të shkollave përkatëse evropiane e më gjerë, sa u përket parametrave e standardeve.

Shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë të gjithë ata ekspertë që me përkushtim të madh punuan në rishikimin e planprogrameve ekzistuese.

II. Kurrikula për profilin “Konstruksionet Metalike”, klasat 10,11 dhe 12

1. Njoftime të përgjithshme për profilin “Konstruksionet Metalike - ”, klasat 10,11 dhe 12

a) Struktura e shkollimit dhe certifikimi.

Arsimimi në profilin mësimor “Konstruksionet Metalike” trajtohet në kuadrin e shkollimit të mesëm të lartë dhe ofrohet në shkollat profesionale dhe në qendrat e kompetencës me dy nivele me kohëzgjatje 3 vite mësimore (kl.10, 11 i takojnë nivelit të tretë dhe klasa e 12-të i takon nivelit të katërtë). Nxënësit të cilët e përfundojnë nivelin e tretë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve mund të pajisen me certifikatë dhe e fitojnë të drejtën për të vazhduar në nivelin e katërt sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Në përfundim të këtij niveli nxënësit fitojnë diplomën me titull “Konstruksionet Metalike” dhe mund të integrohen në tregun e punës dhe/ose të vazhdojnë arsimimin e tyre të mëtejshëm post-sekondar.

Nivelet sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (KKK)

- **Niveli i tretë sipas KKK/(Shkalla e pestë sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës)** i arsimimit profesional, me kohëzgjatje dy vite mësimore pas përfundimit të arsimit të detyruar (kl. 10 dhe 11), i përgatit nxënësit për kompetencat fillestare (hyrëse) të punësimit në profesionin e Konstruksionet Metalikeit jep një certifikatë të përgatitjes profesionale të nivelit të punonjësit të gjysmë kualifikuar (ndihmës) dhe mundëson kalimin në shkallën e gjashtë(6) të arsimimit profesional.
- **Niveli i katërt sipas KKK(Shkalla e gjashtë sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës)** i arsimimit profesional, me kohëzgjatje një vit mësimor (kl. 12) pas përfundimit me sukses të shkallës së pestë, i përgatit nxënësit për të fituar një kualifikim profesional që u mundëson atyre integrimin në tregun e punës për Konstruksionet Metalike, si dhe vazhdimin e arsimimit në nivele më të larta. Jep një diplomë të përgatitjes profesionale të nivelit të punonjësit të kualifikuar dhe mundëson të drejtën për t’ju nënshtruar testit të maturës , e cila ju lejon nxënësve kalimin edhe në studimet universitare ose nivelin post-sekondar.
- Ky dokument përmban kurrikulën të profilit arsimor “Konstruksionet Metalike” për shkallët 5 dhe 6, të strukturuar në:
 - A. Lëndë të kulturës së përgjithshme (programet e tyre jepen në një dokument të veçantë të Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - MASHTI) të cilat synojnë formimin e përgjithshëm të nxënësve.

- B. Module profesionale, përshkruesit e të cilëve jepen në këtë dokument. Këto module synojnë përgatitjen e nxënësve me kompetencat profesionale të nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës në profilin e Konstruksioneve Metalike.

b) Kërkesat e pranimit të nxënësve.

Programet e arsimit të mesëm të lartë profesional janë të hapura për personat që kanë kryer arsimin e detyrueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjet. Përfundimisht, personat deri në 24 vjet mund t'i regjistrojnë programet e arsimit të mesëm të lartë profesional me aprovimin e këshillit të mësimdhënësve të shkollës në pajtim me dispozitat e MASHT, të cilat rregullojnë kushtet dhe kriteret për regjistrimin e nxënësve dhe ndjekësve të shkollave të mesme profesionale. Shkollimin në profilin arsimor **“Konstruksionet Metalike ”** niveli III-të dhe IV-të (sipas **Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve -KKK**) respektivisht shkalla 5 dhe 6 sipas **Kornizës së Kurikut të Kosovës**, mund ta ndjekin të gjithë të rinjtë dhe të rejtat të cilët kanë përfunduar me sukses arsimin e detyruar dhe i përmbushin kriteret e parapara me ligjin e Arsimit Parauniversitar dhe Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Republikën e Kosovës, për zhvillimin e personalitetit, talentit dhe aftësisë mendore e fizike të nxënësve deri në potencialin e tyre të plotë, duke u bazuar në parimet e përgjithshme për; gjithëpërfshirje, qasje, transfer dhe progres, mësim teorik dhe të praktikës profesionale, mbështetje e zhvillimit të karrierës si pjesë e integruar e procesit të mësuarit gjatë gjithë jetës.

c) Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe të punësimit

Arsimimi në profilin Konstruksionet Metalike trajtohet në kuadrin e shkollimit të mesëm profesional. Pas përfundimit të shkollimit nxënësi fiton diplomën profesionale me titull Konstruksionet Metalike, dhe ka mundësi të integrohet në tregun e punës apo shkollim të mëtejshëm në arsimim post - sekondar. Nxënësit të cilët kalojnë me sukses provimin e maturës shtetërore, u lëshohet certifikatë dhe u mundësohet vazhdimi i studimeve në arsimin e lartë.

Përfundimi me sukses i shkollimit për profilin mësimor **“Konstruksionet Metalike”** në **nivelin e III-të sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (shkallën e 5-të sipas Kornizës së Kurikut të Kosovës)**, u lejon nxënësve vazhdimin e shkollimit në nivelin e **IV-të sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (shkallën e 6-të sipas Kornizës së Kurikut të Kosovës)** të këtij profili.

Përfundimi me sukses i shkollimit për profilin mësimor **“Konstruksionet Metalike”**, shkalla e 6-të, ju mundëson të drejtën për t'ju nënshtruar testit të maturës, i cili ju lejon nxënësve kalimin në nivelin post-sekondar dhe arsimin e lartë universitar.

Shkollimi për **“Konstruksionet Metalike”**, niveli III dhe IV, sipas **Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve** (shkalla 5 dhe 6 sipas **Kornizës së Kurikut të Kosovës**), i referohet përpunimit dhe prodhimit të produkteve të të gjitha llojeve në industrinë Konstruksionet Metalikee që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo, punëtori i industrisë së Konstruksionet Metalikeit i aftësuar në nivelin III dhe IV (shkallën 5 dhe 6), punësohet kryesisht në ndërmarrje, reparte dhe servise të ndryshme ku veprimtaritë profesionale lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e makinave Konstruksionet Metalikee, për prodhimet e detaleve metalike si dhe pajisjeve axhusterike dhe saldim për prodhimet e

konstruksioneve metalike. Në varësi të aftësisë profesionale të **Konstruksionet Metalike**, puna kryhet me makina Konstruksionet Metalike me prerje, formësim dhe aparate saldimit.

Detyrat kryesore në proces të kualifikimit të një kandidati në **Konstruksione Metalike** janë: punimi i pjesëve në makina, Konstruksionet Metalike konvencionale, lakimi i llamarinave në makina CNC, si dhe punimi i konstruksioneve metalike (axhusteri-saldim).

Një kandidat i kualifikuar në Konstruksione Metalike mund të specializohet në fushën e **konstruksioneve metalike**.

d) Qëllimet e përgjithshme të shkollimit

Qëllimi kryesor i shkollimit në profilin arsimor të **Konstruksioneve Metalike** është zhvillimi i personalitetit të nxënësve për t'u përfshirë në një shoqëri demokratike si qytetarë aktivë e kompetentë, si dhe për t'u angazhuar me sukses në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Sfidat të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi janë dhe zhvillimi i nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t'u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale. Për të mundësuar zhvillimin individual të nxënësve nga pikëpamja emocionale, intelektuale dhe profesionale, është e nevojshme që shkolla profesionale t'u krijojë atyre:

- Mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, etniteti dhe aftësitë fizike e mendore;
- Kushte për të njohur dhe zbatuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Kushte për t'u njohur me teknologjitë dhe proceset e punës aktuale e të perspektivës, në sektorin e ekonomisë;
- Lehtësi për të kuptuarit e mjedisit shoqëror dhe ekonomik, lokal, kombëtar dhe rajonal, si dhe për të qenë të vetëdijshëm për rolin që mund të luajnë në këtë mjedis;
- Mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe vlerat morale;
- Kushte për t'u zhvilluar psikikisht, emocionalisht dhe fizikisht, për të përballuar sfidat dhe vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- Kushte për tu vlerësuar drejt dhe me realizëm në lidhje me potencialin dhe arritjet e tyre;
- Mbështetje për të marrë përgjegjësi në procesin e zhvillimit të tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional;
- Mbështetje për të zhvilluar format e bashkëpunimit dhe të besimit të ndërsjellë nëpërmjet përvojës së punës praktike;
- Mundësi për t'u njohur me zhvillimet perspektive të profesionit të tyre, të para këto në kontekstet e integritetit rajonal dhe Evropian.

e) Kompetencat e përgjithshme të nxënësve.

Ndjekja e shkollimit në profilin arsimor "**Konstruksionet Metalike**", në nivelin e tretë (shkallën e 5-të), do të zhvillojë te nxënësit një tërësi kompetencash të përgjithshme, të cilat do t'i

shërbejnë atij për përvetësimin me efektivitet të programit mësimor, zhvillimin në nivelin e kërkuar të kompetencave profesionale dhe integrimin e mëtejshëm në shoqëri dhe në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Këto kompetenca të përgjithshme do të zhvillohen në një nivel më të lartë gjatë kryerjes së shkollimit për **“Konstruksionet Metalike”**, në **nivelin e katërt (në shkallën e 6-të sipas Kornizës së Kurikut të Kosovës)**. Kështu, nxënësi do të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte, me shkrim dhe me gojë, për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të komunikojë dhe të përdorë burime të ndryshme informacioni në gjuhë të huaj;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme (përfshirë dhe ato të kompjuterizuara) të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të menaxhojë dhe përdorë me efektivitet burimet në dispozicion në funksion të përmbushjes së objektivave;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në marrjen e vendimeve për zgjidhjen e situatave të ndryshme problemore në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të manifestojë vetëbesim dhe qasje të një kritike konstruktive ndaj zhvillimeve profesionale, personale dhe shoqërore;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm për kërkim të vazhdueshëm në drejtim të zgjidhjeve të reja, më efektive;
- Të zbatojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale dhe globale;
- Të tregojë guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vet-kontroll dhe pavarësi në vendim-marrje në ushtrimin e veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë e vullnetin për një të nxënë që zgjat gjithë jetën;
- Të zbatojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të përbashkëta;
- Të vet-orientohet drejt për karrierën e punësimit dhe shkollimit të mëtejshëm;
- Të vlerësojë dhe vetë-vlerësojë n isur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej të arriturat.

f) Kompetencat profesionale të nxënësve

Me përfundimin me sukses të shkollimit dyvjeçar në profilin **“Konstruksionet Metalike”**, në **nivelin e tretë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (shkallën e 5-të, sipas Kornizës së Kurikut të Kosovës)**, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës për punime të Konstruksionet Metalike;
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e punës;
- Të interpretojë skica, vizatime dhe dokumentacion teknik të punimeve mekanike – Konstruksionet Metalike;
- Të përgatitë skica dhe vizatime teknike të detaleve e të konstruksioneve të thjeshta metalike;
- Të kryejë matje dhe kontrole mekanike me përdorimin e instrumenteve përkatëse;

- Të përzgjedhë veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e duhura për punime të Konstruksionet Metalike;
- Të kryejë vijëzime e shënime të sipërfaqeve, si dhe matje e kontrole të këndeve,
- Të kryejë punime të ndryshme axhusterie (limime, shpime, prerje, filetme, deformime plastike dhe smerilime) me vegla dore dhe mekanike;
- Të kryejë punime të thjeshta dhe mesatare të saldimit me hark elektrik me dorë, saldimit MIG/MAG dhe TIG
- Të kryejë lloje të ndryshme të saldimit me hark elektrik me dorë, saldimit MIG/MAG dhe TIG, në përputhje me standardet përkatëse dhe me skemat e saldimit;
- Të kryejë kontrollin dhe finalizimin e saldimit me hark elektrik me dorë, saldimit MIG/MAG dhe TIG
- Të kryejë kontrollin e saldimit, eliminojë parregullsitë dhe të finalizojë sipërfaqet që Saldohen;
- Të kryejë saldime të kornizave të dyerve dhe të dritareve të thjeshta metalike;
- Të kryejë punime përgatitore saldimit të nyjave të konstruksioneve të thjeshta metalike;
- Të përcaktojë drejt regjimet e punës në trapano shtyllore;
- Të përgatisë trapanon shtyllore për punë;
- Të kryejë shpime, zgjerime, kalizvarime e alezime vrimash me trapano shtyllore (makine shpuese);
- Të kryejë hapje te filetave te jashtme dhe te brendshme me dorë;
- Të përdorë dokumentacionin teknik;
- Të garantojë mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e mjedisit;
- Të respektojë standardet ndërkombëtare të profesionit për Konstruksionet Metalike;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.

Me vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm njëvjeçar në Profilin **“Konstruksionet Metalike”, në nivelin e katërt sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (shkallën e 6-të)** nxënësi do të rrisë në një shkallë më të lartë kompetencat e fituara në nivelin e tretë (shkallën e pestë), si dhe do të aftësohet të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale si më poshtë:

- Të konceptoj planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale të Konstruksioneve Metalike;
- Të kryej llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të Konstruksioneve Metalike;
- Të projektojë procesin teknologjik të prodhimit të detaleve me makina për Konstruksionet Metalike;
- Të përgatitë vizatimet dhe skicat e punës së detaleve që prodhohen me makina Konstruksionet Metalike;
- Të interpretojë dhe të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar për përgatitjen e konstruksioneve metalike;
- Të krijojë dhe të skicojë projektin për konstruksione të thjeshtë metalike;
- Të përgatitë vizatimet dhe skicat e punës për përgatitjen e konstruksioneve metalike;
- Të hartojë procesin teknologjik të realizimit të një konstruksioni të thjeshtë metalik;

- Të përdorë dokumentacionin me të dhëna teknike relative për materialet (llamarina, profile), katalogun e bulonave, dhe madhësitë e vrimave për ribatinat;
- Të organizojë vendin e punës për realizimin e prodhimit të konstruksioneve metalike;
- Të përzgjedhë materialet (copat) për përgatitjen e konstruksioneve metalike;
- Të përzgjedhë makinat dhe pajisjet ndihmëse për përgatitjen e konstruksioneve metalike;
- Të përzgjedhë instrumentet prerëse për përgatitjen e konstruksioneve metalike;
- Të realizojë matje, kontrole dhe shënime për përgatitjen e konstruksioneve metalike;
- Të përgatitë për punë dhe të rregullojë regjimet e punës në makinat për përgatitjen e konstruksioneve metalike;
- Të kryejë punime saldimit të vështirësisë së lartë (kryen punime saldimit vertikal, tavanor dhe unazor, me hark elektrik me dorë) sipas standardit;
- Të kryejë punime saldimit me metodën MIG/MAG dhe TIG;
- Të zbatojë procesin teknologjik dhe të prodhojë konstruksione të ndryshme metalike (dyer dhe dritare, rrethoja, shkalle, porta dhe kapriata metalike e ngjashëm);
- Të prodhojë pjesë metalike me përdorimin e makinave për lakim;
- Të prodhojë pjesë metalike me përdorimin e makinave prerëse;
- Të operojë me makina CNC për prerjen dhe formësimin e llamarinave;
- Të operojë me makina CNC për lakimin këndor të llamarinës;
- Të operojë me makina CNC për lakimin rrethor dhe profilor të llamarinave;
- Të kryejë prerje të llamarinës me plasma, ujë dhe laser;
- Të tregojë kujdesin e duhur dhe të mirëmbajë vendin e punës, veglat, pajisjet, instrumentet dhe makinat për Konstruksionet Metalike;
- Të komunikojë me etikën e duhur në kuadrin e veprimtarisë profesionale;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.

Funksionet e detyrueshme për profesionin – Konstruksionet Metalike, sipas Standardit të profesionit janë si në vijim:

- Zbaton masat e sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit;
- Përgatitë dhe organizon vendin e punës;
- Kryen saldime të pjesëve metalike;
- Punimi dhe montimi i konstruksioneve metalike;
- Operimi me makina CNC për prerjen dhe formësimin e llamarinave;
- Kontribuon në ngritjen e nivelit profesional;
- Kryerja e llogarive për realizimin e punimeve për Konstruksionet Metalike.

Plani mësimor për profilin arsimor “Konstruksionet Metalike”, Niveli 3 dhe 4 i KKK-s

TAB.1

Fusha kurrikulare	Lëndët e përgjithshme dhe modulet profesionale	Kodet	Orët vjetore			Gjithsej
			Shkalla 5 (Niveli 3)		Shkalla 6 (Niveli 4)	
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	
A	Lëndët e përgjithshme		10(350)	10(350)	9(288)	29(988)
Gjuhë dhe komunikim	Gjuhë shqipe dhe letërsi		3 (105)	3 (105)	3 (96)	9 (306)
	Gjuhë angleze		2 (70)	2 (70)	2 (64)	6 (204)
Matematikë	Matematikë		2 (70)	2 (70)	2(64)	6 (204)
Shkencat natyrore	Fizikë		1 (35)	1 (35)	-	2 (70)
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike dhe shëndetësore		2 (70)	2 (70)	2 (64)	6 (204)
B	Modulet Profesionale	Kodet	22 (770)	22 (770)	23 (736)	67(2276)
Jeta dhe puna	TIK	MPP1-10-P MPP1-11-P MPP1-12-P	2(70)	1 (35)	1 (32)	4 (137)
	Materialet teknike	MPP2-10-Mk	2 (70)	-	-	2 (70)
	Mekanikë teknike	MPP3-10-Mk	2 (70)		-	2 (70)
	Vizatimi teknik	MPP4-10-Mk	2 (70)			2 (70)
	Detalet e makinave	MPP5-10-Mk	2 (70)			2 (70)
	Teknologjia e punimeve axhusterike	MPMp-1-10-Mk	6 (210)			6 (210)
	Saldimi me hark elektrik me dorë (HED)	MPMp-2-10-Mk	6(210)			6 (210)
	Saldimi me MIG/MAG	MPMp-2-11-Mk		7 (245)		7 (245)
	Elektroteknikë dhe elektronikë	MPP6-11-Mk		2 (70)	-	2 (70)
	Vizatim me kompjuter (CAD)	MPP7-11-Mk		2(70)		2 (70)
	Konstruksionet metalike–1	MPMp-3-11-Mk		7 (245)		7 (245)
	Punime orendish metalike			2 (70)		2 (70)
	Saldimi me TIG	MPMp-3-12-Mk			7 (224)	7 (224)
	Konstruksionet metalike– 2	MPMp-2-12-Mk			7 (224)	7(224)
	Teoria e prodhimit dhe organizimi i ndërmarrjes	MPP7-11-P MPP7-12-P		1 (35)	1 (32)	2 (67)
	Solidworks	MPP8-12-Mk			3 (96)	3 (96)
Makinat CNC për prerje dhe formësim	MPMp-4-12-Mk			2 (64)	2 (64)	
Punime me llamarinë metalike				2(64)	2(64)	
Gjithsej (A+B)	Gjithsej		32(1120)	32 (1120)	32 (1024)	96 (3264)

Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë

- Në Shkollat e Mesme të Larta Profesionale (SHMLP) dhe në Qendrat e Kompetencës (QK) përgatitja profesionale e nxënësve realizohet me anë të “moduleve profesionale”, të cilët janë me përmbajtje teorike - praktike. Në Planin mësimor të Kurrikulës tregohet lista e moduleve profesionale, të cilët janë të detyrueshme të zbatohen dhe nuk mund të ndryshohen nga shkollat.
- Modulet profesionale janë të përgjithshme dhe specifike për profilin. Modulet e përgjithshme për profilin **Konstruksionet Metalike** janë: *Materialet teknike, Mekanikë teknike, Vizatimi teknik, Detalet e makinave; Elektroteknikë dhe elektronikë; Vizatim me kompjuter (CAD),* . Modulet specifike për profilin **Konstruksionet Metalike** janë: *Teknologjia e punimeve axhustrike; Saldimi me hark elektrik me dorë (HED); Saldimi me MIG/MAG; Elektroteknikë dhe elektronikë; Konstruksionet metalike–1,2; Punime orendish metalike -1,2; Solidworks; Makinat CNC për prerje dhe formësim; Punime me llamarinë metalike*
- Modulet: TIK dhe Teoria e prodhimit dhe organizimi i ndërmarrjes janë pjesë e fushës kurrikulare *Jeta dhe Puna*.
- Pjesa zgjedhore – Nxënësit në klasat 10, 11 dhe 12 duhet të kenë më shumë se një modul në dispozicion për zgjedhjen e njërit prej tyre që kanë më shumë interesim ta mësojnë.
- Kurrikula përmban “përshkruesit e moduleve profesionale”, të cilët duhet të zhvillohen dhe të detajohen më tej nga vetë mësimezhënësit dhe instruktorët e QK dhe SHMLP. Gjatë përgatitjes së programeve mësimore të hollësishme, mësimezhënësit/instruktorët duhet të kenë parasysh që për çdo modul profesional *Rezultatet Mësimore* dhe *Kriteret e Vlerësimit* të nxënësve janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen prej tyre. Ndërsa, përmbajtjet e rubrikave të tjera të moduleve profesionale janë *rekomanduese* dhe mund të përshtaten nga vetë mësimezhënësit-instruktorët në përputhje me zhvillimet më të fundit në profesionet përkatëse dhe kushtet konkrete për zbatimin e moduleve.
- Edhe nëse modulet profesionale do të trajtohen nga mësimezhënës të veçantë, gjatë përgatitjes së programeve mësimore të hollësishme dhe gjatë zbatimit të tyre duhet të ketë një *bashkëpunim* të ngushtë të gjithë ekipit të mësimezhënësve/instruktorëve që trajtojnë modulet profesionale të kualifikimit profesional përkatës.
- Për modulet profesionale, si njësi matëse e ngarkesës mësimore do të përdoret koncepti i *Kredisë*, ku një Kredi është i barasvlerëshëm me 20 orë mësimore dhe ku një orë mësimore ka një kohëzgjatje prej 45 minutash.
- Përmbushja me sukses e moduleve profesionale kërkon *integrimin e teorisë me praktikën* e profesionit dhe për këtë parimi i “*të nxënit duke bërë*” duhet të zbatohet gjerësisht në procesin mësimor.

- Njohja e vazhdueshme e nxënësve me Rezultatet e të Mësuarit që përmbajnë përshkruesit e moduleve si dhe me Kriteret e Vlerësimit përkatës ndihmon në nxitjen e *motivimit* të nxënësve dhe lehtëson përvetësimin e kompetencave profesionale.
- Mësimdhënësit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimore të tilla që të fuqizojnë maksimalisht të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ata të kompetencave sociale e profesionale të plota dhe të qëndrueshme.
- Rekomandohet që mësimdhënësit/instruktorët e moduleve profesionale të përdorin metoda mësimore që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe sjelljet dhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. Metoda e *punës në grup* duhet të jetë në themel të organizimit të mësiminot teorik dhe praktik për të zhvilluar te nxënësit *kompetencat profesionale*, të nevojshme për të përballuar me sukses vështirësitë që kanë të bëjnë me veprimtarinë e ardhshme profesionale, me vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm, si dhe me veprimtarinë shoqërore si qytetar i një shoqërie demokratike.
- Një parim tjetër që duhet të zbatohet nga mësimdhënësit/instruktorët e moduleve profesionale është që *të nxënësve nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave, puna hulumtuese dhe studimet e rastit të nxënësve kanë një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm.
- Rekomandohet që në trajtimin e Rezultateve Mësimore teorike të moduleve të përdoren metoda të tilla si *ligjërrata, dhënia e shembujve, zgjidhja e problemit teorik, dhënia e detyrave* etj. Ndërsa, në trajtimin e Rezultateve Mësimore praktike të përdoren kryesisht *demonstrimi nga mësimdhënësi, praktika e mbikëqyrur dhe praktika e pavarur e nxënësve*.
- Mësimdhënësit/instruktorët që trajtojnë modulet profesionale duhet të respektojnë *individualitetin* e nxënësve duke nxitur përparimin e shpejtë të nxënësve të përparuar dhe duke mbështetur nxënësit e prapambetur me veprimtari mësimore te veçanta.
- Në kushtet e mungesës së mjediseve reale të punës për punë praktike të nxënësve, rekomandohet që në QK dhe SHMLP të krijohen *mjedise të simuluar të punës*.
- QK dhe SHMLP duhet të krijojë *lidhje të ngushta me bizneset lokale* që kryejnë veprimtari në kualifikimet profesionale përkatëse, për të mundësuar praktikimin e nxënësve dhe marrjen e informatave për zhvillimet në profesionet përkatëse.
- Për sa i përket **vlerësimit të nxënësve**, rekomandohet të përdoren metoda dhe instrumente vlerësimi që nxisin krijimin e kompetencave të nxënësve, shmangin subjektivizmin në vlerësim dhe tregojnë arritjet reale të tyre. Me rëndësi është vlerësimi i *vazhdueshëm* dhe ai *përfundimtar*, ku format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit përzgjidhen apo hartohen nga vetë mësimdhënësit. Duhet të synohet vlerësimi i arritjeve *i bazuar në kriteret* (ku arritjet e nxënësit krahasohen me standardet e paracaktuara) dhe të shmanget sa më shumë të jetë e mundur *vlerësimi i bazuar në renditjen* (ku nxënësit krahasohen me njëri-tjetrin). Metodat dhe instrumentet e vlerësimit që rekomandohen janë: pyetjet - përgjigjet me gojë, pyetjet - përgjigjet me shkrim, detyrat me shkrim, vëzhgimi i veprimtarisë së nxënësve, listat e kontrollit të veprimtarive praktike dhe të produkteve të punës, projekte për vlerësimin etj.
- *Lista e kontrollit* duhet të jetë instrumenti bazë për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve, të testuara në situata pune reale apo të simuluar.

- Mësimdhënësit/instruktorët duhet të përgatisin *Instrumentet e vlerësimit* të nxënësve për çdo Rezultat Mësimor të paraqitur në përshkruesit e moduleve profesionale, duke u bazuar në Kriteret e vlerësimit përkatës.
- Detyra përfundimtare mbulon të gjitha kriteret e vlerësimit të një RM-je, disa RM-ve apo të një moduli.
- Verifikimi i brendshëm i vlerësimit – Metodatat e vlerësimit duhet të jenë në funksion të rezultateve mësimore të moduleve dhe kualifikimit përkatës. Vlerësimi duhet të jetë transparent dhe i dokumentuar; secili nxënës duhet të ketë portfoliot me dëshmi për aktivitetet për të gjitha llojet e vlerësimit: teste, projekte, prezantime, punën praktike, detyra dhe forma të tjera të cilat ndërlidhen me modulet e kualifikimit. Vlerësuesi (mësimdhënësi, instruktori dhe në raste koordinatori i cilësisë) duhet të ketë portfoliot që dëshmon se verifikimi i brendshëm është bërë sipas planifikimit, janë plotësuar të gjitha format e verifikimit të Instrumenteve të vlerësimit dhe vendimeve të vlerësimit, si dhe janë respektuar procedurat dhe afatet kohore për informata kthyesë dhe komente për nxënësit. Portfoliot e nxënësve dhe mësimdhënësve duhet të shërbejnë si dëshmi edhe për verifikuesit e jashtëm.
- Në rastin e nxënësve me *aftësi të kufizuara*, mësuesit duhet të përshtatin programet e hollësishme të moduleve profesionale në përputhje me mundësitë fizike të këtyre nxënësve, si dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për zbatim.
- Në përgjithësi, si për procesin mësimor, ashtu edhe për vlerësimin e nxënësve, duhet të synohen forma dhe metoda që e vendosin *nxënësin në qendër* të veprimtarive mësimore dhe e shndërrojnë rolin e mësimdhënësit nga një lektor i thjeshtë, në një organizator, mbikëqyrës, nxitës dhe vlerësues i veprimtarisë së nxënësve.

PËRSHKRUESIT E MODULEVE

KLASA 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

“TIK”

Klasa 10

Titulli i Kualifikimit: Konstruksionet Metalike

Vlera e Kredive të Modullit: 3.5 Kredi (70 orë mësimore)

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit “TIK”, klasa 10:

RM1: Nxënësi tregon arkitekturën e kompjuterit dhe funksionalitetin e komponentëve harduerike;

RM2: Nxënësi instalon sistemin operativ;

RM3: Nxënësi konfiguron rrjetin kompjuterik standard;

RM4: Nxënësi shfrytëzon internetin;

RM5: Nxënësi shfrytëzon softuerin aplikativ.

RM1: Nxënësi shpjegon ndërtimin fizik të kompjuterit personal
Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:
<ul style="list-style-type: none"> – Kupton konceptet themelore në teknologjinë informative; – Përshkruan përdorimin e teknologjisë informative në fusha të ndryshme dhe në shoqëri; – Përshkruan ndërtimin dhe mënyrën e funksionimit të kompjuterit; – Shpjegon komponentët e brendshme dhe të jashtme dhe mënyrën e funksionimit; – Identifikon komponentët e brendshme dhe të jashtme të kompjuterit personal; – Demonstron leximin e shënimeve në pajisjet e ndryshme në kompjuterë; – Liston gjeneratat e ndryshme të kompjuterëve; – Përshkruan veçoritë dalluese të gjeneratave të kompjuterëve; – Tregon aplikimin e kompjuterëve në fusha të ndryshme; – Paraqet shkathtësi për masa mbrojtëse në punë.
Kushtet e nevojshme:
<ul style="list-style-type: none"> – Laboratori; – Tabela; – Projektori; – Kompjuterë; – Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogët etj.); – Listat e të dhënave; – Materiale konkretizimi si: (pllaka amë, kartela të ndryshme, furnizuesi i rrymës, procesori, memorie, hard disk etj.); – Qasja në internet etj.
Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> – Kupton konceptet themelore në teknologjinë informative; – Përshkruan përdorimin e teknologjisë informative në fusha të ndryshme; – Përshkruan ndërtimin dhe mënyrën e funksionimit të kompjuterit; – Shpjegon komponentët e brendshme dhe të jashtme dhe mënyrën e funksionimit; – Dallon njësitë hyrëse dhe dalëse të kompjuterit; – Liston gjeneratat e ndryshme të kompjuterëve; – Përshkruan veçoritë dalluese të gjeneratave të kompjuterëve; – Tregon aplikimin e kompjuterëve në fusha të ndryshme;
Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> – Identifikon komponentët e brendshme dhe të jashtme të kompjuterit personal; – Demonstron leximin e shënimeve në pajisjet e ndryshme në kompjuterë; – Liston gjeneratat e ndryshme të kompjuterëve; – Paraqet shkathtësi për masa mbrojtëse në punë.
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> – Komunikimi, – Bashkëpunimi, – Diskutim,

- Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja,
- Mbledh dhe përpunon informata,
- Të menduarit logjik,
- Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve,
- Të jetë kritik dhe konstruktiv,
- Punë në grup,
- Punë në dyshe etj.

Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:

Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me shkrim,
- Pyetje - përgjigje me gojë,
- Listë kontrolli,
- Informata kthyesë,
- Teknika e vrojtimit,
- Detyra të shtëpisë.

Evidentimi i Vlerësimit: informime për politikat e personelit

- Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit.
- Testi me shkrim, kombinim i pyetjeve me përgjigje të përputhshme, me përgjigje të shumëfishtë ose me përgjigje të shkurtër.
- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura.
- Lista e kontrollit duhet të verifikojë aftësinë e nxënësit që të dallojë pajisjet e jashtme dhe të brendshme, lexojnë shënimet në pajisjet e ndryshme, lexojnë performansat e kompjuterit, dallojnë gjeneratat e kompjuterëve etj.

RM2: Nxënësi instalon sistemin operativ

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- Numëron sistemet operative;
- Dallon sistemet operative;
- Përkufizon sistemet operative dhe rolin e tij në sistemin kompjuterik;
- Përshkruan ndërfaqet (interfejsat) dhe gjuhët e ndryshme komanduese;
- Demonstron instalimin e sistemit operative;
- Zbaton procedurat për formatizimin dhe ndarjen e hard diskut;
- Punon në nivel bazë me sistemet operative DOS, WINDOWS, UNIX, LINUX.

Kushtet e nevojshme:

- Laboratori
- Tabela;
- Projektori;
- Kompjuterë;

<ul style="list-style-type: none"> – Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogë, DVD me sisteme operative, softuerët sistemor etj.); – Listat e të dhënave; – Qasja në internet etj.
<p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Numëron sistemet operative; – Dallon sistemet operative; – Përkufizon sistemet operative dhe rolin e tij në sistemin kompjuterik; – Përshkruan ndërfaqet (interfejsat) dhe gjuhët e ndryshme komanduese; – Përshkruan komandat beç (<i>batch</i>) të thjeshta; – Shpjegon zhvillimin e sistemit operativ.
<p>Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Demonstron instalimin e sistemit operative; – Zbaton procedurat për formatizimin dhe ndarjen e hard diskut; – Punon në nivel bazë me sistemet operative DOS, WINDOWS, UNIX, LINUX.
<p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Komunikimi; – Bashkëpunimi; – Diskutim; – Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja; – Mbledh dhe përpunon informata; – Të menduarit logjik; – Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve; – Të jetë kritik dhe konstruktiv; – Punë në grup; – Punë në dyshe etj.
<p>Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:</p>
<p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Pyetje - përgjigje me shkrim; – Pyetje - përgjigje me gojë; – Listë kontrolli; – Informata kthyesë; – Teknika e vrojtimit; – Prezantime të detyrave të ndryshme.
<p>Evidentimi i Vlerësimit: informime për politikat e personelit:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit; – Testi me shkrim, kombinimi i përgjigjeve të përputhshme, zgjidhjeve të shumëfishta; – Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura; – Lista e kontrollit duhet të verifikojë aftësinë e nxënësit që ta dallojë sistemet operative të instaluar, të punojë në nivel bazë në secilin sistem operativ, të instalojë sisteme të

ndryshme operative etj.

RM3: Nxënësi konfiguron rrjetin kompjuterik standard

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- Përkufizon rrjetin kompjuterik;
- Kupton të gjitha komponentët kryesore të rrjetit;
- Tregon veçoritë e komponentëve të rrjetit;
- Shpjegon përparësitë dhe mangësitë e rrjeteve të bazuara në server dhe rrjetat e lidhura ballë-për-ballë;
- Shpjegon dallimin në mes konfigurimit pikë me pikë ose shumëpikësh;
- Shpjegon modelet e rrjetave;
- Klasifikon mediumet transmetuese të rrjetave;
- Demonstron instalimin e rrjetit lokal;
- Demonstron konfigurimin e një rrjete standarde për komunikim kompjuterik;
- Shfrytëzon administrimin e të dhënave prej një kompjuteri në tjetrin.

Kushtet e nevojshme:

- Laboratori;
- Tabela;
- Projektori;
- Kompjuterë;
- Materiale të nevojshme (katalogë, listat e të dhënave, listat eksperimentuese, veglat për eksperimentim dhe instrumentet për matje etj.);
- Listat e të dhënave;
- Qasja në internet etj.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Përkufizon rrjetin kompjuterik;
- Kupton të gjitha komponentët kryesore të rrjetit;
- Tregon veçoritë e komponentëve të rrjetit;
- Shpjegon përparësitë dhe mangësitë e rrjeteve të bazuara në server dhe rrjetat e lidhura ballë-për-ballë;
- Shpjegon dallimin në mes konfigurimit pikë me pikë ose shumëpikësh;
- Tregon karakteristikat dhe përdorimet e topologjive të ndryshme të rrjetit;
- Shpjegon modelet e rrjetave;
- Shpjegon modelin TCP/IP dhe IP adresat;
- Klasifikon mediumet transmetuese të rrjetave;
- Shpjegon përparësitë dhe mangësitë e modëve të ndryshme të transmetimit.

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Demonstron instalimin e rrjetit lokal;
- Demonstron konfigurimin e një rrjete standarde për komunikim kompjuterik;
- Shfrytëzon administrimin e të dhënave prej një kompjuteri në tjetrin.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi;
- Bashkëpunimi;
- Diskutim;
- Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja;
- Mbledh dhe përpunon informata;
- Të menduarit logjik;
- Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve;
- Të jetë kritik dhe konstruktiv;
- Punë në grup;
- Punë në dyshe etj.

Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:**Metodat e Vlerësimit:**

- Pyetje - përgjigje me shkrim;
- Pyetje - përgjigje me gojë;
- Listë kontrolli;
- Informata kthyese;
- Teknika e vrojtimit;
- Projekte të ndryshme.

Evidentimi i Vlerësimit: informime për politikën e personelit

- Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit;
- Testi me shkrim, kombinimi i përgjigjeve të përputhshme, zgjidhjeve të shumëfishta;
- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura;
- Lista e kontrollit duhet të verifikojë aftësinë e nxënësit si: instalimin e rrjetit lokal; konfigurimin e një rrjete standarde, administrimin e të dhënave prej një kompjuteri në tjetrin etj.

RM4: Nxënësi shfrytëzon internetin**Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:**

- Kupton përparësitë e shfrytëzimit të postës elektronike;
- Shpjegon dërgimin dhe pranimin e E-mail mesazhit;
- Demonstron përdorimin e E-mail aplikacionit;
- Shfrytëzon bisedat e drejtpërdrejta;
- Shpjegon internetin dhe www (World Wide Web);
- Numëron shërbimet në internet;
- Numëron aplikacionet e shfletuesit të WEB-it (WEB browser);
- Demonstron përdorimin e Web browser-eve të ndryshëm;
- Shfrytëzon kërkimin e informacioneve ;
- Zbaton organizimin e faqeve në internet;

<ul style="list-style-type: none"> – Demonstron Download dhe Upload (zbritë dhe ngarkon programe); – Demonstron mbledhjen e informatave nga aplikacioni i Web-it (www).
Kushtet e nevojshme:
<ul style="list-style-type: none"> – Laboratori; – Tabela; – Projektori; – Kompjuterë; – Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogë etj.); – Listat e të dhënave; – Qasja në internet etj.
Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> – Kupton përparësitë e shfrytëzimit të postës elektronike; – Numëron përparësitë dhe të metat e postës elektronike dhe asaj tradicionale; – Shpjegon dërgimin dhe pranimin e E-mail mesazhit; – Shpjegon organizimin e E-mail aplikacionit; – Shpjegon internetin dhe www (World Wide Web); – Numëron shërbimet në internet; – Kupton navigimin nëpër internet; – Numëron aplikacionet e shfletuesit të WEB-it (WEB browser).
Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> – Demonstron përdorimin e E-mail aplikacionit; – Shfrytëzon bisedat e drejtpërdrejta; – Demonstron përdorimin e Web browser-eve të ndryshëm; – Shfrytëzon kërkimin e informacioneve ; – Zbaton organizimin e faqeve në internet; – Demonstron Download dhe Upload; – Demonstron mbledhjen e informatave nga aplikacioni i Web-it (www);
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> – Komunikimi; – Bashkëpunimi; – Diskutim; – Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja; – Mbledh dhe përpunon informata; – Të menduarit logjik; – Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve; – Të jetë kritik dhe konstruktiv; – Punë në grup; – Punë në dyshe; – Punë individuale etj.
Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:
Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me shkrim;
- Pyetje - përgjigje me gojë;
- Listë kontrolli;
- Informata kthyesë;
- Teknika e vrojtimit;
- Prezantime të ndryshme.

Evidentimi i Vlerësimit: informime për politikat e personelit

- Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit;
- Testi me shkrim, kombinimi i përgjigjeve të përputhshme, zgjidhjeve të shumëfishta;
- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura;
- Lista e kontrollit duhet të verifikojë aftësinë e nxënësit në përdorimin dhe organizimin e aplikacioneve të postës elektronike dhe aplikacioneve të WEB-it (WEB browser).

RM5: Nxënësi shfrytëzon softuerin aplikativ

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- Shpjegon softuerin aplikativ;
- Përkufizon kuptimin dhe përdorimin e softuerit për përpunim të tekstit;
- Shpjegon përpunimin dhe formatizimin e tekstit;
- Demonstron krijimin, përpunimin dhe shtypjen e dokumentit në letër;
- Demonstron kompetencë në përdorimin e disa veçorive më të avancuara në dokument;
- Shpjegon softuerin aplikativ për prezantim;
- Shpjegon krijimin, formatizimin dhe dizajnimin e sllajdeve;
- Demonstron aftësi për kryerjen e operacioneve themelore me grafikë dhe diagrame;
- Demonstron shfaqjen e prezantimit;
- Përkufizon kuptimin dhe përdorimin e softuerit për tabela dhe baza të të dhënave;
- Shpjegon librin e punës (Workbook);
- Përdorë formula dhe funksione të ndryshme;
- Demonstron paraqitjen grafike të dhënave të tabelës;
- Shpjegon shtypjen e librit punues në letër;
- Demonstron kompetencë në përdorimin e disa veçorive më të avancuara;
- Demonstron detyra projektuese të avancuara.

Kushtet e nevojshme:

- Laboratori;
- Tabela;
- Projektori;
- Kompjuterë;
- Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogë etj.);
- Listat e të dhënave;
- Qasja në internet etj.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Shpjegon softuerin aplikativ;
- Numëron softuerët aplikativ;
- Përkufizon kuptimin dhe përdorimin e softuerit për përpunim të tekstit;
- Shpjegon përpunimin dhe formatizimin e tekstit;
- Shpjegon softuerin aplikativ për prezantim;
- Shpjegon krijimin, formatizimin dhe dizajnimin e sllajdeve;
- Përkufizon kuptimin dhe përdorimin e softuerin për tabela dhe baza të të dhënave;
- Shpjegon librin e punës (Workbook), fletat punuese (sheets) dhe editimin e të dhënave;
- Shpjegon adresimin relativ dhe absolute;
- Shpjegon shtypjen e librit punues në letër.

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Shfrytëzon insertimin e objekteve në dokument;
- Përdorë tabela të ndryshme në dokument;
- Demonstron krijimin, përpunimin dhe shtypjen e dokumentit në letër;
- Demonstron kompetencë në përdorimin e disa veçorive më të avancuara në dokument;
- Demonstron aftësi për kryerjen e operacioneve themelore me grafikë dhe diagrame;
- Përdorur efekte të ndryshme të paraqitjes së prezantimit;
- Demonstron shfaqjen e prezantimit;
- Përdorë formula dhe funksione të ndryshme;
- Shfrytëzon insertimin e objekteve të ndryshme;
- Demonstron paraqitjen grafike të të dhënave të tabelës;
- Demonstron kompetencë në përdorimin e disa veçorive më të avancuara;
- Demonstron detyra projektuese të avancuara.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi;
- Bashkëpunimi;
- Diskutim;
- Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja;
- Mbledh dhe përpunon informata;
- Të menduarit logjik;
- Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve;
- Të jetë kritik dhe konstruktiv;
- Punë në grup;
- Punë në dyshe;
- Punë individuale etj.

Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:

Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me shkrim;
- Pyetje - përgjigje me gojë
- Listë kontrolli;
- Informata kthyesë;

- Teknika e vrojtimit.

Evidentimi i Vlerësimit: informime për politikat e personelit

- Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kritereve të vlerësimit;
- Testi me shkrim, kombinimi i përgjigjeve të përputhshme, zgjidhjeve të shumëfishta;
- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura;
- Lista e kontrollit duhet të verifikojë aftësinë e nxënësit në krijimin dhe përpunimin e dokumentit, krijimin e prezantimeve të ndryshme dhe për situata të ndryshme duke përdorur efekte të ndryshme të paraqitjes së prezantimit dhe demonstrimin e detyrave të ndryshme projektuese në Excel.

DRAFT

PËRSHKRUESI I MODULIT

“MATERIALET TEKNIKE ”

Klasa 10

Titulli i Kualifikimit: Konstruksionet Metalike

Vlera e Kredive të Modullit: 3.5 Kredi (70 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit “Materialet teknike”, klasa 10:

RM1: Nxënësi përshkruan strukturën dhe vetitë e materialeve teknike

RM2: Nxënësi përshkruan llojet e metaleve, mënyrën e përdorimit dhe përfitimit të tyre.

RM3: Nxënësi përshkruan llojet e metaleve me ngjyrë dhe legurat, mënyrën e përdorimit dhe përfitimit.

RM4: Nxënësi përshkruan llojet e jometaleve, mënyrën e përdorimit dhe përfitimit.

RM5: Nxënësi përshkruan llojet e materialeve për djegie, mënyrën e përdorimit dhe përfitimit.

RM6: Nxënësi përshkruan llojet e materialeve për lyerje, mënyrën e përdorimit dhe përfitimit.

RM7: Nxënësi përshkruan llojet e fluideve punuese, ajri, uji, gazi, mënyrën e përdorimit dhe përfitimit.

RM1: Nxënësi përshkruan strukturën dhe vetitë e materialeve teknike
Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:
<ul style="list-style-type: none">- Përshkruaj ndërtimin kristalor të metaleve;- Shpjegoj strukturën e materialëve teknike;- Tregon strukturën e materialëve teknike;- Përshkruaj vetitë e materialeve teknike;- Përcaktoj vetitë e materialeve teknike;- Shpjegoj provat me dhe pa shkatërrim të materialeve;- Përzgjedh provat me dhe pa shkatërrim të materialeve.
Kushtet e nevojshme:
<ul style="list-style-type: none">- Klasë mësimore;- Metale, metale me ngjyra, jometale, karburant, vajra, uji dhe gazra të ndryshme;- Materiale të shkruara;- Mjete dhe materiale vizualizuese.
Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:
<ul style="list-style-type: none">- Përshkrimi i ndërtimit kristalor të metaleve;- Shpjegimi i strukturës së materialëve teknike;- Përshkrimi i vetive të materialeve teknike;- Shpjegimi i provave me dhe pa shkatërrim të materialeve.
Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi
<ul style="list-style-type: none">- Tregon strukturën e materialëve teknike;- Përcakton vetitë e materialeve teknike;

- Përzgjedh provat me dhe pa shkatërrim të materialeve.
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi; - Bashkëpunimi; - Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja; - Mbledh dhe përpunon informata; - Të menduarit logjik; - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve; - Të jetë kritik dhe konstruktiv; - Punë në grup.
Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:
Metodat e Vlerësimit:
<ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me shkrim; - Pyetje - përgjigje me gojë.
Evidentimi i Vlerësimit: informime për politikat e personelit
<ul style="list-style-type: none"> - Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të 5-7 kritereve të vlerësimit me karakter teorik; - Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapur.

RM 2:Nxënësi përshkruan llojet e metaleve, mënyrën e përdorimit dhe përfitimit.
Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:
<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegoj mënyrën e përfitimit të hekurit teknik.; - Tregoj llojet e hekurit teknik; - Përzgjedh llojet e hekurit teknik; - Tregoj llojet e hekurit të papërpunuar; - Përzgjedh llojet e hekurit të papërpunuar; - Tregoj llojet e hekurit të derdhur; - Përzgjedh llojet e hekurit të derdhur; - Tregoj llojet e gizës; - Përzgjedh llojet e gizës; - Shpjegoj mënyrën e përfitimit të çelikut, çelikut të leguruar dhe të derdhur; - Shpjegoj vetitë e çelikut dhe përdorimin; - Tregoj ndarjen e profilit; - Tregoj shënimin e çelikut sipas standardit ISO; - Njoftoj me mënyrën e përfitimit të çelikut, çelikut të leguruar dhe të derdhur ; - Përcaktoj vetitë e çelikut; - Përzgjedh çelikun sipas standardit ISO.
Kushtet e nevojshme:
<ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore; - Kompjuter dhe mjete komunikimi; - Materiale të shkruara;

- Mjete dhe materiale prezantuese dhe vizualizuese.
Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegimi i mënyrës se përfitimit të hekurit teknik; - Tregimi i llojeve të hekurit teknik; - Tregimi i llojeve të hekurit të papërpunuar; - Tregimi i llojeve të hekurit të derdhur; - Tregimi i llojeve të gizës; - Shpjegimi i mënyrës se përfitimit të çelikut, çelikut të leguruar dhe të derdhur; - Shpjegimi i vetive të çelikut dhe përdorimit; - Tregimi i ndarjes së profilit; - Dalloni çelikun sipas shënimit me standard ISO.
Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja e llojeve të hekurit teknik; - Përzgjedhja e llojeve të hekurit të papërpunuar; - Përzgjedhja e llojeve të hekurit të derdhur; - Përzgjedhja e llojeve të gizës; - Njoftimi me mënyrës se përfitimit të çelikut, çelikut të leguruar dhe të derdhur; - Përcaktimi i vetive të çelikut; - Përzgjedhja e çelikut sipas standardit ISO.
Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:
